

"XHAMIA MBRET"

KY ËSHTË PROFETI MUHAMMED

صَلَّى اللّٰهُ
عَلَيْهِ
وَسَلَّمَ

Salallahu alejhi ue selem!

WWW.XHAMIAMBRET.COM

"Pejgamberi është më afër besimtarëve (dhe më i merituar) se sa vet ata për veten." (El-Ahzab 6).

Titulli i origjinalit:

ملسو هيلء الله ىاصل وسرلا وا هءه

Titulli në shqip:

**Ky është Profeti ynë Muhamed (paqja dhe bekimi
i Zotit qofshin mbi të)**

Përktheu:

Shpëtim Shushku

Elbasan,

www.xhamiambret.com



Përmbajtja

Para shpalljes	3
Pas shpalljes.....	5
Emigrimi (Hixhreti).....	8
Lufta në rrugën e Allahut.....	10
Çlirimi (i Mekës)	12
Mrekullitë	15
▪ Kurani famëlartë.	15
▪ Israja dhe Miraxhi.	16
▪ Ndarja e Hënës.....	16
▪ Gurët që madhëronin Allahun.....	17
▪ Shërimi i të sëmurëve.	17
▪ Profecitë për të ardhmen.	17
▪ Begatia dhe zhvillimi.	17
Cilësitë	18
Para Profetit a.s. dhe pas tij	23
Kanë thënë rreth tij	26

سم الله الرحمن الرحيم

Ky është Profeti ynë (Muhamed) paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të

Para shpalljes

Në Gadishullin Arabik, në një zonë që shtrihet mes malesh shkëmbore e të zeza, pranë Kabes së Shenjtë, të cilën e ngriti Babai i të gjithë

profetëve, Ibrahim, me djalin e tij Ismailin (paqja e Allahut qoftë mbi ta), pesëqind e shtatëdhjetë vjet pas lindjes së Isait (paqja e Allahut qoftë mbi të), lindi njeriu më i mirë i të gjitha kohërave, Muhamedi, i biri i Abdullah ibn Abdul Mutalibit, nga një baba i pashëm dhe fytyrëndritur dhe nga një nënë fisnike prej një dere të lartë, me emrin Amine bintu Uehb, nga fisi Kurejsh, që sundonte të gjitha fiset arabe, që i shërbente Vendit të

Shenjtë (Kabes) dhe mburrej për pozitën dhe fisnikërinë që kishte ndër fiset e tjera.

Ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) lindi jetim, sepse i ati i vdiq që kur nëna e tij ishte shtatzënë me të. Ky fëmijë i bekuar u dërgua të rritej në shkretëtirë (nën kujdestarinë e një gruaje nomade), që të mësonte gjuhën e kulluar arabe, si dhe të merrte shëndet të plotë dhe moral të lartë. Kur mbushi gjashtë vjeç, i vdiq edhe e ëma, duke e lënë nën kujdestarinë e gjyshit të tij, Abdul Mutalibit dhe njerëzve të tij. Kudo që të qëndronte ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) kishte një begati të madhe dhe u hyri në zemër të gjithëve, aq sa filluan të garonin kush e kush ta merrte nën kujdestarinë e tij.

Ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) u rrit në një mjedis, ku arabët ishin të përçarë, në luftë me njëri-tjetrin, të devijuar

nga feja e Allahut që ua lanë atyre Ibrahim
dhe Ismaili (paqja e Allahut qoftë mbi ta),
duke adhuruar idhujt, në një ideologji mitike
dhe ishin pjesë e asaj historie që nuk ia
vlente të përmendej për asgjë.

Ky djalosh u rrit dhe u njoh në popullin e tij
si “i çiltri, i besueshmi”, aq sa zonja fisnike
Hadixhe bintu Huejlid i besoi atij tregtinë e saj
në Sham. Ai diti të ishte një tregtar i drejtë dhe i
suksesshëm, prandaj kjo zonjë e nderuar i
propozoi të martohej me të dhe martesë u
realizua, duke ndërtuar kështu familjen më të
lumtur në botë.

Pas shpalljes

Para se t’i zbriste shpallja, Muhamedi (paqja
dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) mendonte
dhe hulumtonte për gjithësinë e krijuar nga
Zoti. Kur mbushi dyzet vjeç, i zbriti shpallja dhe

fjala e parë që iu tha ishte: “**Lexo!**”. Ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) u kthye te bashkëshortja e tij i trembur dhe duke u dridhur, por ajo e qetësoi duke i thënë se ai ishte njeri i mirë dhe se Allahu i donte atij, veçse të mirën. Ajo (Allahu qoftë i kënaqur me të) u këshillua për këtë edhe me një nga të afërmit e saj, Uaraka ibn Neufelin, që kishte njohuri rreth Shkrimeve të Shenjta. Ai ia komentoi këtë ngjarje si një sihariq të mirë dhe i tha se Shkrimet e Shenjta lajmëronin për një profet nga arabët dhe se do të dëshironte të jetonte aty gjatë sa ta shihte këtë profet, t'a besonte e t'a përkrahte edhe ai vetë.

Shpallja filloi t'i zbriste vazhdimisht Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) dhe ai u urdhërua që t'i ftonte njerëzit në adhurimin e Allahut, Një të Vetëm, të bënin vepra të mira dhe t'u largoheshin të këqiave. Ai e nisi me njerëzit më të afërt të tij dhe në fillim e besuan bashkëshortja e tij Hadixhe, shoku i tij

Ebu Bekri, djali i xhaxhait të tij, Ali ibn ebi Talibi që jetonte në shtëpinë e tij dhe disa njerëz të tjerë, që e pranuan ftesën dhe që ishin nga shtresa të ndryshme të shoqërisë, si: tregtarë, fisnikë, burra, gra, të lirë dhe skllevër.

Por arabët në përgjithësi, e kundërshtuan dhe e refuzuan ftesën e tij. Atyre iu duk e rëndë të linin ritet e baballarëve, prandaj i përbuzën ata që e besuan Muhamedin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) dhe filluan t'i përgënjeshtrojnë, t'i ndëshkonin, t'i rrihnin dhe t'i masakronin muslimanët, derisa arritën edhe t'u bënin atyre embargo dhe bojkot të plotë, por të gjitha këto nuk i sprapsën muslimanët nga feja e tyre.

Emigrimi (Hixhreti)

Një grup nga shokët e Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), të detyruar nga dhuna e kurejshëve, emigruan për në Abisini (Etiopia e sotme). Abisinia kishte një mbret të drejtë kristian me emrin Nexhashi, i cili u ndikua nga propaganda e muslimanëve dhe pas njëfarë kohe e pranoi edhe vetë Islamin. Më vonë filloi emigrimi për në Jethrib (Medine), pasi Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) u takua me një delegacion që vinte prej andej, i njohu me Islamin dhe ata e besuan me bindje. Me kthimin e delegacionit, Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) nisi me ta Musab ibn Umejrin, që t'u mësonte rregullat e fesë islame dhe të ishte ambasadori i tij në Medine. Me thirrjen e Musabit, Allahu e futi Islamin në shumicën e shtëpive të Medines. Pas një viti, nga Medine u nis një delegacion i madh për t'u takuar me Profetin (paqja dhe bekimi i

Allahut qofshin mbi të), ku ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) i ftoi ta përkrahnin dhe ta ndihmonin në ftesën e tij dhe ata pranuan duke i dhënë besën. Që këtu nisi emigrimi i begatë për në Medine, gjatë të cilit Ebu Bekri ishte shoqëruesi i Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), nën mbrojtjen dhe kujdestarinë e Allahut të Madhëruar, derisa arritën në Jethrib, vend i cili u quajt “Medineja e Shndritshme”. Banorët e këtij qyteti u lumturuan nga ardhja e Vulës së Profetëve (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) tek ata, me një lumturi që s’e kishin provuar kurrë më parë.

Këtu Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) nisi menjëherë të themelonte bazat e shtetit islam, duke filluar me tri kryesoret:

- 1. Ndërtimin e Xhamisë** (që ishte kurora e të gjitha institucioneve të mëvonshme).
- 2. Vëllazërimin e njerëzve**, që më parë ishin të përçarë (vendosja e rendit publik).
- 3. Përpilimin e kushtetutës së brendshme dhe sistemit të jetesës së qytetarëve, muslimanë dhe jomuslimanë.**

Lufta në rrugën e Allahut

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) e mbushi jetën e muslimanëve në Medinë me moralin e tij të lartë, me thjeshtësinë, guximin dhe udhëheqjen e tij të drejtë, sa u bë për ta baba, udhëheqës, prijës, këshilltar dhe udhëzues. Pasi erdhi urdhri nga Allahu i Lartësuar, Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) përgatiti ushtrinë dhe zhvilloi betejat në mbrojtje të shtetit të besimit dhe në ngritjen e fesë së vërtetë. Në betejën e madhe të Bedrit, ushtria e vogël dhe e dobët e

besimtarëve triumfoi ndaj ushtrisë arrogante dhe të madhe të jobesimtarëve, ku Allahu e ndau të drejtën nga e kota, e mbështeti Profetin dhe e ngadhënjeu fenë e Tij.

Islami shpalosi një sistem të përkryer jetese, që mbante një vizion gjithëpërfshirës për të tashmen dhe të ardhmen. Kështu u rrënjos fuqia e muslimanëve, prandaj kundër tyre u bashkuan të gjitha fiset arabe dhe bishtat e tyre, në betejën e Ahzabit, por ata u befasuan kur panë se muslimanët kishin gërmuar një hendek përreth Medines. Natën e asaj beteje, një natë e errët dhe e ftohtë, Allahu u dërgoi jobesimtarëve një erë të fortë e të frikshme, që ua shkuli tendat e i bëri t'ia mbathnin nga kampet e tyre dhe të ktheheshin nga kishin ardhur.

Më vonë, fisi Kurejsh lidhi një pakt me Profetin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin

mbi të).

Ky u quajt “Pakti i Hudejbijes” dhe ishte një arritje e madhe për muslimanët. Pasi u vendos armëpushimi dhe njerëzit u ndjenë të sigurtë, muslimanët filluan të përziheshin me jobesimtarët dhe t’i ftonin ata në fenë e drejtë, t’ua lexonin Kuranin dhe t’u kumtonin atyre mësimet e Islamit. Prandaj, çdo njeri me mendje të shëndoshë që u ftua në Islam, e pranoi dhe e përqafoi atë si fenë e tij.

Çlirimi (i Mekës)

Kur fisi Kurejsh e shkeli paktin e arritur, të gjithë muslimanët u nisën në xhihad drejt Mekës Madhështore dhe arritën ta merrnin atë pa luftë. Kjo ndodhi në vitin e tetë pas emigrimit në Medine. Muslimanët e zhveshën Mekën nga pamja e saj pagane dhe e pastruan Shtëpinë e Shenjtë (Kaben) nga idhujt. Me këtë u zhduk paganizmi nga zemrat e njerëzve dhe u përhap

Islami në të gjithë Gadishullin Arabik, duke bashkuar kështu fise e njerëz që askush nuk e mendonte se mund të bashkoheshin, mbi të cilët sunduan drejtësia dhe siguria, në një vend ku sundonin lufta dhe trazirat. Kufijtë e Islamit u zgjeruan dhe u përmbush fjala e Allahut të Madhëruar: ***“Ne të dërguam ty si mëshirë për botët.”*** Pastaj u dërguan letrat e thirrjes në Islam te mbretërit dhe udhëheqësit e asaj kohe, midis të cilëve disa iu përgjigjën pozitivisht fesë së re dhe disa të tjerë filluan përgatitjet për luftë.

Vdekja e Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të)

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) ishte një njeri, ai vepronte si të gjithë njerëzit e tjerë, përveç mëkateve dhe atyre gjërave që binin në kundërshtim me moralin e lartë dhe me natyrën e profetëve. Ai hante,

pinte, flinte, gëzohej, dëshpërohej, martohej, sëmurej dhe... vdiste. E vullneti i Allahut ishte që ai të ndërronte jetë, pasi njerëzit u futën masivisht në fenë e Tij dhe muslimanët morën përsiper të mbanin lart flamurin e Islamit dhe ta mbronin atë pas tij (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

Shokët e Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) i dhanë atij lamtumirën dhe u tronditën nga ndarja me të dashurin e tyre, por interesi i Islamit i bashkoi ata të këshilloheshin mes tyre, ashtu siç i mësoi Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) dhe zgjodhën një prijës që t'a pasonte e t'a zëvendësonte atë (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të). Ky prijës u vendos të ishte shoku më i ngushtë i Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), Ebu Bekri (Allahu qofte i kenaqur me të), i cili e udhëhoqi Umetin (besimtarët) drejt lavdisë.

Mrekullitë

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) jetoi mes popullit të tij dyzet vjet dhe u njoh prej tyre në atë kohë si njeri me çilteri dhe besnikëri të rrallë. Kur i erdhi shpallja dhe u urdhërua që t'i ftojë njerëzit në Islam, Allahu i dha edhe shumë mrekulli, që të ishte edhe më i besueshëm. Ndër mrekullitë e tij (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) më të mëdha janë:

- **Kurani famëlartë.**

Ai u zbrit në gjuhën e arabëve me një retorikë të pashembullt dhe i sfidoi ata – e vazhdon t'i sfidojë – që të formonin sikur edhe një kapitull të vetëm si kapitujt e tij, meqë ishin oratorë dhe autorë të poemave madhështore (por ata as mundën e as që mundin t'a bëjnë këtë). Ndërsa Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) nuk njihej si poet, përkundrazi, dihej që ishte analfabet, që s'dinte

as të shkruante e as të lexonte, e pikërisht për këtë arsye, Kurani ishte një mrekulli, që do të mbetet përjetë e tillë.

▪ **Israja dhe Miraxhi.**

Israja është udhëtimi i Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) nga Medineja në Jeruzalem dhe kthimi i tij prej andej, brenda natës. Ky udhëtim u zgjaste njerëzve në atë kohë një muaj plot. Ai ua përshkroi atyre Jeruzalemin në një mënyrë që e përforconte sinqeritetin e tij dhe shumë prej atyre që e dëgjuan këtë gjë, e besuan dhe e pasuan atë në fenë e tij. *Miraxhi* është ngjitja e tij në qiell, gjatë së cilës pa me sytë e tij çuditë e krijimit të Allahut.

▪ **Ndarja e Hënës.**

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) bëri shenjë me dorë nga Hëna dhe njerëzit e panë atë të ndarë në dy pjesë (nga fuqia e Allahut).

▪ **Gurët që madhëronin Allahun.**

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) mori disa guralecë në dorë dhe njerëzit i dëgjuan ata të thoshin: “Subhanallah, Subhanallah!” (i Lartë është Allahu, i Lartë është Allahu!).

▪ **Shërimi i të sëmurëve.**

Profeti mjekoi sëmundje të ndryshme në zemër dhe trup, plagë dhe sy të shkullur që nga rrënjët dhe të gjitha këto u bënë me lejen e Allahut të Madhëruar.

▪ **Profecitë për të ardhmen.**

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) u zbuloi qëllimet që kishin në zemër disa njerëzve në kohën e tij dhe ka lajmëruar për ngjarje që do të ndodhnin në të ardhmen. Disa prej tyre kanë ndodhur tashmë dhe disa të tjera pritet të ndodhin.

▪ **Begatia dhe zhvillimi.**

Ai i zgjaste dorën gjirit të një deleje dhe ai mbushej plot me qumësht, e vinte dorën në një

enë me ushqim ose pije dhe nga ajo hanin e pinin me qindra vetë, e megjithatë masa e ushqimit dhe ujit mbetej e njëjtë.

Gjithsesi, Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) ka pasur shumë më tepër mrekulli sesa mund të përmendim.

Cilësitë

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) kishte natyrën më të plotë njerëzore. Ai kishte cilësitë dhe moralin më të mirë që mund të ketë një krijesë. Mjafton për këtë të dëgjosh se si e ka cilësuar ai veten: *“Jam dërguar që të përmbush moralet fisnike.”*

Allahu i Lartësuar thotë për të: *“Ti vërtet ke një moral të lartë.”* dhe: ***“Ne të dërguam ty si mëshirë për botët.”*** Andaj, ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) është mëshirë për të

gjithë njerëzit: gra, burra dhe fëmijë, mëshirë për zogjtë dhe kafshët, mëshirë për të gjitha krijesat e Allahut. Një nga dëshmitë më të mëdha të kësaj, është edhe fakti se ai i thirri të gjithë njerëzit në adhurimin e Zotit dhe Krijuesit të tyre të Vetëm: ***“Ju erdhi juve nga Allahu një dritë dhe një Libër i Qartë. Allahu udhëzon me të, ata të cilët me kënaqësinë e Tij ndjekin rrugën e paqes, i nxjerr ata nga errësira në dritë me lejen e Tij dhe i udhëzon në rrugën e drejtë.”*** Për këtë mision, Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) duroi vuajtje që s’i ka përjetuar asnjë profet tjetër. Madje, edhe në rastet më të vështira, kur populli i tij i shkaktoi shumë vuajtje dhe tallje, zemra e tij ishte plot me mëshirë, prandaj nga goja e tij nderuar dolën vetëm fjalë të përjetshme, që nënvizojnë kushtetutën e faljes dhe mëshires: ***“O Allah! Fale popullin tim, sepse ata nuk dinë (se ç’po bëjnë)!”***.

Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) vuri peshoren mes kësaj bote dhe botës së përtejme, kur disa muslimanë deshën ta vinin veten në një pozitë të rëndë jetese dhe njëri prej tyre tha se s'do të hante më mish dhe do të agjëronte gjithë jeten, një tjetër tha se s'do të bënte më marrëdhënie bashkëshortore dhe i fundit tha se s'do të flinte më mbi një shtrat. Kur Profetit i erdhën në vesh fjalët e tyre tha: *“Si e kanë hallin disa njerez? Unë vetë agjëroj dhe ha, fle dhe çohem, ha mish dhe bëj marrëdhënie bashkëshortore! Prandaj kush i largohet sunetit tim (mënyrës sime të jetesës), ai s'është si unë (pasuesi im).”*. Megjithatë, ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) ishte njeriu që e adhuronte më shumë Zotin e tij, falej natën derisa i fryheshin këmbët dhe kur Aishja – Nëna e besimtarëve – i thoshte: *“Përse falesh keshtu, kur Allahu t'i ka falur të gjitha gjynahet e mëparshme dhe të mëvonshme?”*, ai i përgjigjej: *“Përse të mos jem*

njeri falënderues (ndaj Allahut)!?”

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) ishte njeriu më i vendosur në rrugën e drejtë. Atë e tunduan shumë dhe i ofruan propozime, i bënë shumë kërcënime dhe i shkaktuan shumë vuajtje, që ta ndalonin të përhapte mesazhin dhe përgjigja e tij (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) ishte: *“Pasha Allahun! Sikur ta vinin diellin në dorën time të djathtë dhe hënën në dorën time të majtë, që unë të heq dorë nga misioni im, nuk do të heq dorë derisa Allahu ta shpalosë atë (fenë, mesazhin tim), ose të vdes për këtë çështje.”*. Ai ishte njeriu që Allahu i dha një guxim të pamatë, aq sa Aliu (Allahu qoftë i kenaqur me të) ka thënë për të: *“Kur gjendeshim në vështirësi – gjatë betejave – mbroheshim me Profetin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) dhe askush nga ne nuk ishte më afër armikut se ai.”*

Por e gjithë kjo nuk e pengonte Profetin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) të ishte më fytyrëçeluri, më buzagazi, më i buti, me karakterin më të mirë dhe më i sjellshmi me familjen, shokët e tij dhe me të gjithë njerëzit. I nderonte bashkëshortet e tij dhe të gjithë anëtarët e tjerë të familjes, i përkëdhelte dhe luante me ta, sillej mirë dhe me dashuri me ta dhe thoshte për të na mësuar edhe ne të tjerëve: *“Më i miri nga ju është më i miri në familjen e tij dhe une jam më i miri në familjen time. Gratë i nderon vetëm një njeri i nderuar dhe ato i poshtëron vetëm një njeri i poshtër.”* Ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) e ndihmonte familjen në punët e shtëpisë, i bënte vetë shërbim vetes, u shkonte për vizitë muslimanëve të dobët dhe u jepte zemër atyre, i vizitonte të sëmurët dhe merrte pjesë nëpër xhenaze. Ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) ishte shembulli më i lartë në thjeshtësi,

megjthëse kishte pozitën më të lartë në shoqërinë e tij.

Gjithsesi, për të kanë zbritur ajete kuranore që dëshmojnë për moralin e lartë që i dha atij Allahu dhe për virtytet e tij madhështore, sikurse thotë Allahu i Lartmadhëruar në fillim të sures “Kalem”, duke iu drejtuar Profetit dhe duke ia bërë të qartë të gjitha krijesave të Tij epërsinë morale të të Dërguarit të Tij (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të): ***“Nun! Pasha kalemin (lapsin) dhe çka ai shkruan! Me mirësinë që të ka dhënë ty Zoti yt, ti nuk je i çmendur. Ti ke një shpërblim të merituar. Ti ke vërtet një moral të lartë.”***.

Para Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) dhe pas tij

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) solli një ndryshim rrënjësor në jetën e njerëzimit. Këtu do të

përmendnim këto fakte:

- I drejtoi njerëzit nga Allahu, Krijuesi i tyre i Vërtetë. I udhëzoi ata të adhurojnë dhe t'i mbështeten vetëm Zotit të tyre.

- Mesazhi i tij i liroi mendjet e njerëzve nga mitologjia dhe iluzionet dhe i bëri ato të meditojnë për universin dhe vetet e tyre.

- Korrigjoi konceptet e deformuara në besimin e ithtarëve të librit (kristianët dhe çifutët) dhe e ktheu besimin në rrënjën e vet të zanafillës.

- E vendosi Sheriatin (ligjin) hyjnor që të qeverisë jetën morale, shoqërore, ekonomike dhe politike të njerëzve.

- I doli në krah gruas, e cila më parë ishte e shtypur nga shoqëria, poshtërohej, shitej dhe blihej dhe më pas ajo u bë mësuese, edukatore, dijetare dhe ndërtuese civilizimesh.

- I bëri arabët sundimtarë të botës, kur

më parë ishin vetëm barinj delesh. I pajtoi armiqtë dhe ata u bënë vëllezër. I barazoi të gjithë popujt, arabë dhe të tjerë, të gjithë vëllezër të një besimi dhe prej tyre u formua shoqëria më e mirë që kishte njohur ndonjëherë historia njerëzore.

- Zhduku diskriminimin racial dhe vendosi që baza e epërsisë midis njerëzve të ishte besimi, përkushtimi dhe mirësjellja.

- Ngriti shtetin islamik mbi bazat e drejtësisë dhe vëllazërisë, shtet që punon për përhapjen e së mirës dhe zhdukjen e së keqes, që mbron njerëzit e dhunuar, ndihmon njerëzit e përvuajtur dhe i nxjerr robërit nga adhurimi për robërit e tjerë, në adhurimin e Zotit të robërve.

- Konkretizoi mësimet e Kuranit në jetën e përditshme dhe ishte (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) një Kuran i gjallë që ecte mbi tokë, shembulli që

besimtarët duhet të ndjeknin.

■ Ndërtoi një urë të sigurtë mes jetës së kësaj bote dhe asaj të botës së përtejme, prandaj shokët e tij ishin murgjit e natës dhe kalorësit e ditës. Ai u mësoi atyre që të mbjellin farën në këtë botë dhe t'i presin të korrat në botën tjetër, e këto janë mëshira dhe Xheneti (parajsa) i përgatitur nga Allahu, sa madhësia e qiejve dhe e tokës.

Kanë thënë rreth tij

Michael H. Hart, i lindur më 1933, shkencëtar amerikan, i diplomuar disa herë, në fizikë dhe drejtësi. Në vitin 1975 merr doktoratën për astronomi nga universiteti i Brinstonit. Ka punuar në disa qendra kërkimore dhe në NASA. Është një nga shkencëtarët më në zë në fizikën praktike, autor i librit “Njëqind të parët”:

“Zgjedhja ime, që Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) të jetë në krye të listës që përmbledh personat, të cilët kanë pasur ndikimin më të madh botëror në të gjitha fushat, ndoshta i ka habitur shumë prej lexuesve..., por unë besoj se Muhamedi (paqja dhe

bekimi i Allahut qofshin mbi të) është njeriu i vetëm në histori, i cili pati suksesin më të madh dhe më të dalluar në të dy nivelet, atë fetar dhe atë shekullar.

“Në të vërtetë, nëse marrim në konsideratë forcat shtytëse të pushtimeve islamike, do të shohim se Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) është lideri politik më madhështor i të gjithë brezave.

“Ky bashkim i veçantë dhe i pashoq, për një ndikim të dyfishtë fetar dhe shekullar, e bën Muhamedin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) të konsiderohet personi me

ndikimin më të madh në historinë e njerëzimit.”.

Washington Irving (1783-1859), shkrimtar dhe politikan amerikan:

“Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) ishte Vula e Profetëve dhe më i Madhi i të Dërguarve, të cilët Zoti i dërgoi t’i thërrasin njerëzit në adhurimin e Tij. Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) është mëshirë për botët dhe besimi në të është fitore e madhe. Merreni personalitetin e tij si shembullin më të lartë për t’u ndjekur dhe do të gjeni një besim të palëkundur dhe një sukses të shndritshëm, në dashtë Zoti!

“Me gjithë fitoret ushtarake të Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), ai nuk pati mendjemadhësi apo arrogancë, sepse luftoi për Islamin, jo për interesat e tij vetjake. Bile edhe në kulmin e lavdisë së tij, ai e ruajti thjeshtësinë dhe modestinë. Atij nuk i pëlqente

që njerëzit të ngriheshin në këmbë për ta nderuar ose për ta mirëpritur, kur ai shkonte tek ata. Nëse ai synonte të formonte një shtet të madh, ai ishte shteti islamik, të cilin e qeverisi me drejtësi dhe nuk mendoi që t'ia trashëgonte atë familjes së tij.

“Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), çdo pasuri që merrte nga xhizjet ose trofetë, e shpenzonte për fitoren e Islamit dhe për të ndihmuar të varfërit muslimanë.

Shpeshherë ai shpenzonte edhe kacidhen e fundit që i kishte mbetur... Ai nuk la trashëgim asnjë dinar, dirhem apo skllav... Allahu e la të zgjidhte mes çelsave të thesareve të tokës dhe mes Ahiretit, dhe ai zgjodhi Ahiretin.”

Cte. Henry de Castries (1850-1927), kont, komamandant i ushtrisë franceze, ka kaluar një kohë të gjatë në Afriken e Veriut:

“Është e qartë pra, se Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) nuk ka lexuar ndonjë libër të shenjtë dhe as është udhëzuar në fenë e tij nga ndonjë sekt i mëparshëm... Nuk mund t’i mohohet Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) në turin e parë të jetës së tij, besimi i plotë dhe sinqeriteti i pastër. Sa për besimin e tij, ai nuk i është lëkundur asnjë grimcë në zemër gjatë turit të dytë (turi i Medines). Fitoret që ai arriti, do t’ia shtonin besimin, por besimi i tij kishte arritur në një pikë që s’pranonte më shtesa. Ai nuk anohej nga luksi dhe as ka qenë neqez. Ishte njeri i thjeshtë, u nda nga kjo botë pa u ngopur ndonjëherë as me bukë elbi. Ishte i zhveshur nga lakmia, megjithatë arriti të merrte pozicionin më të lartë në vendin e arabëve. Por kjo nuk e bëri atë diktator, ai s’kishte as shpurë dhe as ministra.”

Louis Sédillot (1808-1876), orientalist francez:

“Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), ishte njeri i butë dhe i drejtë. I merrte të varfërit në shtëpinë e tij për të ndarë me ta ushqimin që kishte. Ai i priste me butësi dhe mirësjellje të gjithë ata që donin ta pyesnin dhe i magjepste bashkëbiseduesit me atë shprehi të qetë, të shndritshme dhe të qeshur që kishte në fytyrë. Nuk mërzitej nga bisedat e gjata, fliste pak dhe me thjeshtësi, pa kurrfarë mendjemadhësie.”

Henry Serouya, orientalist francez:

“Civilizimi i vërtetë mendor intelektual, u shfaq – tek arabët – vetëm pas ardhjes së Profetit Muhamed (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).”

Laura Veccia Vaglieri (1893-1989), orientaliste italiane. Ka studiuar historinë

islame, gjuhën dhe letërsinë arabe. Prej shkrimeve të saj, përmendim “Në mbrojtje të Islamit”: “Armiqtë më të egër të Islamit, pasi i verboi urrejtja, u përpoqën që t’i mveshin Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) disa akuza të trilluara. Harruan se Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), para se t’i zbriste shpallja ishte njeri i nderuar dhe i besuar në popullin e tij, për shkak të çiltërsisë dhe jetës së tij të pastër. Është e çuditshme që këta njerëz nuk e marrin mundimin ta pyesin veten se si arriti Muhamedi të duronte kërcënimet me zjarrin e përjetshëm të Xhehenemit ndaj gënjeshtarëve dhe hipokritëve, që përmenden në disa ajete kuranore, nëse ai vetë ishte një gënjeshtar. Si guxoi ai të thërriste në fenë e tij, po të mos kishte fuqi të brendshme të vazhdueshme që e shtynin atë, duke qenë se ishte njeri me natyrë të thjeshtë!? Si mundi të përballonte një betejë që dukej e pashpresë!? Si pati mundësinë t’a

vazhdonte këtë betejë për dhjetë vjet në Mekë me një arritje fare të vogël, duke u përballur me vuajtje të panumërta, nëse nuk do të kishte besim të thellë në vërtetësinë e mesazhit të tij!? Si rastisi që t'a besonte atë një numër i madh njerëzish fisnikë dhe të zgjuar, ta përkrahin dhe të hynin në fenë e tij, duke u bërë pjesë e një shoqërie të solidarizuar, ku shumica e saj ishin skllevërit, varfanjakët dhe të mjerët, nëse nuk do të ndjenin në fjalën e tij ngrohtësinë e sinqeritetit!? S'është e nevojshme të sqarojmë më shumë. Edhe përëndimorë kanë rënë në ujdë për faktin se sinqeriteti i Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) ishte i thellë dhe i sigurtë.

“Profeti arab (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) i thirri paganët, kristianët dhe çifutët me një zë të frymëzuar dhe të lidhur ngushtë me Zotin e tij..., në besimin më të kulluar monoteist. Ai ishte i gatshëm të

luftonte haptazi disa bindje prapanike njerëzore, të cilat e shtyjnë njeriun që t'i bëjë shokë Krijuesit, 'zota' të tjerë."

Montgomery Watt, i lindur më 1909. Orientalist anglez, ish dekan i degës së "Studimeve Arabe dhe Islame" në universitetin "Adinbra" (Skoci):

"Që kur **Carlyle** bëri studimin e tij rreth Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) në librin "Heronjtë", Perëndimi e kuptoi se ka shumë arsye bindëse për singeritetin e Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), sepse vullneti i tij për të duruar dhunën që u ushtrua ndaj tij për shkak të besimit të tij, morali i lartë i atyre burrave që e besuan atë, dhe së fundmi madhështia e arritjeve të tij, dëshmojnë për integritetin dhe ndershmërinë e tij të palëkundur. Prandaj, të supozosh se Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) është një mashtrues, më shumë krijon

probleme sesa zgjidh. E megjithatë, nuk ka ndonjë personalitet të madh të historisë që është zhvlerësuar më shumë në Perëndim sesa Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të). Shkrimtarët perëndimorë e kanë shfaqur prirjen e tyre për të besuar gjërat më të keqia rreth Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).. dhe nuk mjafton që kur përmendim virtytet e tij, të mjaftohemi me besueshmerinë dhe vendosmërinë e tij, nëse duam të kuptojmë çdo gjë rreth tij, apo të korrigjojmë gabimet e trashëguara nga e kaluara në lidhje me të. Por ne duhet ta pranojmë fuqimisht singleritetin e tij për çdo rast, kur nuk ka ndonjë argument të prerë për të kundërtën.

“Sa më shumë të mendojmë për historinë e Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) dhe për historinë e fillimit të Islamit, aq më shumë na mahnit madhështia e kësaj vepre. S’ka dyshim se rrethanat ishin të volitshme për Muhamedin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin

mbi të) dhe i dhanë atij një mundësi suksesi, që i është dhënë veçse një pakice njerëzish, por nga ana tjetër, ai ishte plotësisht në nivelin e atyre rrethanave. Po të mos kish qenë profet, burrë shteti dhe qeverisjeje, po të mos kishte besim të plotë tek Allahu dhe se Ai e kishte dërguar atë, nuk do të kishte shkruar një kapitull të rëndësishëm në historinë njerëzore. Unë shpresoj se ky studim rreth jetës së Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), do të ndihmojë për të zgjuar interesin, edhe një herë nga e para, për një njeri që është më madhështori ndër pasardhësit e Adamit.”

Gustave Le Bon (1841-1931), mjek dhe historian francez, është marrë me qytetërimet orientale:

“Nëse njerëzit do të mateshin me punët e tyre të lavdishme, Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) do të ishte nga më madhështorët që ka njohur historia. Dijetarët e

Perëndimit kanë filluar t'a vlerësojnë drejt Muhamedin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), megjithëse fanatizmi fetar ua ka errësuar shikimin shumë prej historianëve, që t'a pranojnë madhështinë e tij.”

Sipas fjalëve të Prof. **Hurgronje**:

“Liga e kombeve, që u themelua nga profeti i Islamit, vendosi parimet e bashkimit ndërkombëtar dhe vëllazërisë njerëzore, të cilat ishin pishtar për kombet e tjera. E vërteta është se asnjë komb në botë, nuk mund të matet me atë çka bëri Islami për realizimin e idesë së Lidhjes së Kombeve.”

Sarojini Naidu, poetja e famshme indiane, duke folur mbi aspektin e barazisë përpara Zotit, thotë:

“Është feja e vetme që ka predikuar dhe praktikuar demokracinë. Demokracia në Islam konkretizohet pesë herë në ditë, kur

adhuruesit mblidhen në xhami pasi dëgjohet thirrja për falje, ku njeriu i thjeshtë dhe mbreti gjunjëzohen krah për krah dhe deklarojnë: ‘Allahu është më i Madhi’... Unë jam habitur herë pas here nga bashkimi i pandashëm i Islamit, që i bën njerëzit instinktivisht vëllezër.”

Prof. Jules Masserman thotë:

“...Ndoshta lideri më i madh i të gjitha kohërave ishte Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të)... Ai ishte Cezari dhe Papa në një; por ishte Papë pa pretendimet e Papës dhe Cezar pa legjionet e Cezarit, pa ushtri në gadishmëri, pa truproja, pa pallate e oborre dhe pa të ardhura fikse. Nëse do të kishte ndonjë njeri të drejtën për të thënë se sundon me të drejtën hyjnore, ai do të ishte Muhamedi, sepse kishte të gjithë pushtetin, pa pasur instrumentet dhe suportet e një pushteti.

“Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) e përshkruante veten gjithmonë si ‘shërbëtor (rob) dhe të dërguar të Zotit’ dhe në fakt, gjithmonë ka vepruar ashtu siç ka deklaruar.

“Sot, edhe pas kalimit të katërmbëdhjetë shekujve, jeta dhe mësimet e Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) kanë mbijetuar pa asnjë humbje të përfillshme, ndryshim apo deformim.”

Filozofi britanik **Georges Bernard Shaw** thotë:

“(Islami) Është feja e vetme në harmoni me të gjitha fazat e ndryshme të jetës. Unë mendoj se Muhamedi duhet të quhet shpëtimtari i njerëzimit. Nëse një njeri si ai po të sundonte botën, do t’i zhdukte problemet e saj.”

Edward Gibbon dhe **Simon Oakley**, duke folur mbi pranimin e Islamit shkruajnë: “Shprehja ‘Unë besoj në një Zot të Vetëm dhe

Muhamedi është i Dërguari i Zotit', është pranimi i thjeshtë dhe i pandryshueshëm i Islamit... Imazhi intelektual për Perëndinë, nuk është poshtëruar kurrë me ndonjë idhull të shikueshëm; nderi për Profetin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) nuk i ka kaluar caqet e përmasave të virtyteve njerëzore; udhëzimet morale të jetës së tij, e kanë mbajtur vlerësimin e ndjekësve të tij për të, brenda kufijve të logjikës dhe fesë."

Lamartine, historiani i shquar francez, duke folur për thelbin e Madhështisë Njerëzore habitet:

"Nëse madhështia e synimit, pakica e pasurisë dhe mjeteve, dhe rezultatet mahnitëse janë tre kritere të një njeriu gjenial, kush do të guxonte të krahasonte cilindo njeri të madh të historisë moderne me Muhamedin!? Njerëzit më të famshëm kanë ndërtuar vetëm armë, ligje dhe perandori ... Ky njeri ka lëvizur jo vetëm

armë, legjislacione, perandori, popuj dhe dinasti, por miliona njerëz në një të tretën e botës së banuar; dhe më shumë se kaq, ai ka lëvizur idetë, besimet dhe shpirtrat... Të gjitha këto dëshmojnë jo për një mashtrim, por për një bindje të patundur, e cila i dha atij fuqi të ripërtërijë një dogmë. Kjo dogmë ishte e dyfishtë, njësimi i Zotit dhe jomaterializimi i Tij...”

Mahatma Ghandi, duke folur për karakterin e Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) thotë në “India e Re”:

“Do të doja të dija sa më tepër për atë që sot mban nën ndikim në mënyrë të padiskutueshme, zemrat e miliona njerëzve... Tashmë jam më shumë se i bindur që nuk ishte shpata ajo, që i hapi terren Islamit në ato ditë të intrigave të jetës. Ishte thjeshtësia e vazhdueshme, modestia absolute e profetit,

vlerësimi i ndërgjegjshëm për amanetin (detyrën) e tij, përkushtimi i madh ndaj shokëve dhe ndjekësve të tij, trimëria dhe paepshmëria e tij, besimi absolut në Zotin dhe misionin e tij. Këto dhe jo shpata, hapën çdo gjë para tyre dhe me to kapërcyen çdo pengesë.”

